



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Histori

23 qershor 2026

Varianti A

Shënim:

- Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet me zhvillim dhe arsytim, që kanë më shumë se një mundësi zgjidhjeje.
- Çdo zgjidhje e dhënë nga nxënësit ndryshe nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, do të marrë pikët përkatëse.
- Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa vlerësohen me 1 pikë.

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	C	D	A	B	B	C	B	D	D	B
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Alternativa e saktë	B	A	B	C	C	B	D	D	C	B

Pyetjet me zhvillim dhe arsytim

Pyetja 21 **3 pikë**

Model përgjigje:

- a) Procesi i formimit të etnosit ilir është zhvilluar gjatë një periudhe relativisht të gjatë kohore nga epoka e eneolitit deri në mesin e epokës së bronzit. **1 pikë**
- b) Maliqi, Treni, shpella e Nezirit, shpella e Gajtanit, shpella e Shtoit, etj. **1 pikë**
- c) Varrimi me tuma, etj. **1 pikë**

a) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton saktë kohën historike përgjatë të cilës ka kaluar procesi i formimit të etnosit ilir.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton një prej vendbanimeve ilire.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton një dukuri që dëshmon se në procesin e formimit të etnosit ilir ka ndikuar edhe popullsia e ardhur gjatë dyndjes indoevropiane.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Shtresa e parë, kleri.
- Shtresa e dytë, fisnikët.
- Shtresa e tretë, popullsia e qyteteve.

3 pikë Nëse nxënësi përcakton të tri shtresat e shoqërisë franceze që bënin pjesë në Përfaqësitë e Përgjithshme (vitet 1295-1314).

2 pikë Nëse nxënësi përcakton dy nga shtresat e shoqërisë franceze që bënin pjesë në Përfaqësitë e Përgjithshme (vitet 1295-1314).

1 pikë Nëse nxënësi përcakton një shtresë të shoqërisë franceze që bënte pjesë në Përfaqësitë e Përgjithshme (vitet 1295-1314).

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **3 pikë****Model përgjigje:**

Në tokat arbërore, gjatë sundimit bizantin, u ndeshën këto kategori të pronave dhe të zotëruesve të tyre:

Toka	Përdoruesi/Zotëruesi
Stratiotika – pronë tokësore shtetërore e kushtëzuar me detyrim ushtarak.	Stratioti – fshatari, ushtar në kohë lufte.
Pronia - pronë tokësore shtetërore e kushtëzuar me detyrim ushtarak.	Proniari – feudali, zotërues toke, ushtarak në kohë lufte.
Bashtina - pronë tokësore private.	Bashtinari – pronari i tokës.
Territoria - pronë tokësore private jashtë qytetit.	Fisnikët e qytetit – pronar toke.
Tokat e institucioneve fetare - pronë tokësore private.	Kleriku – pronar toke.

3 pikë Nëse nxënësi identifikon tri nga kategoritë e pronave dhe zotëruesit e tyre në tokat arbërore, gjatë sundimit të Perandorisë Bizantine.

2 pikë Nëse nxënësi identifikon dy nga kategoritë e pronave dhe zotëruesit e tyre në tokat arbërore, gjatë sundimit të Perandorisë Bizantine.

1 pikë Nëse nxënësi identifikon një kategori të pronave dhe zotëruesit e tyre në tokat arbërore, gjatë sundimit të Perandorisë Bizantine.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Industrializimi solli rritjen numerike të klasës së mesme, si edhe të punëtorëve të industrisë, profesionistëve të lirë dhe intelektualëve.
- U shtua numri i njerëzve të profesioneve të lira të angazhuar në fusha të reja të krijimtarisë materiale e ideore.
- Zhvillimi i industrisë dhe tregtisë u shoqërua me procesin e urbanizimit.
- Urbanizimi vetë si proces u shoqërua me probleme të mprehta sociale.
- Qytetet nuk mund të përballonin vërshimin e madh të atyre që kërkonin punë.
- Kushtet higjeno-sanitare ishin të këqija. U përhapën shumë sëmundje epidemike.
- Etj.

3 pikë Nëse nxënësi rendit tri nga ndryshimet kryesore që ndodhën në aspektin social për Evropën Perëndimore, për shkak të Revolucionit të Parë Industrial.

2 pikë Nëse nxënësi rendit dy nga ndryshimet kryesore që ndodhën në aspektin social për Evropën Perëndimore, për shkak të Revolucionit të Parë Industrial.

1 pikë Nëse nxënësi rendit një ndryshim kryesor që ndodhi në aspektin social për Evropën Perëndimore, për shkak të Revolucionit të Parë Industrial.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **4 pikë****Model përgjigje:**

- a) Idetë kryesore politike të shprehur në dokument janë: **1 pikë**
- barazia e njerëzve para ligjit.
 - liria si e drejtë natyrore.
 - sovraniteti i popullit (nënkuptuar nga "bashkimi politik").
 - të drejtat natyrore (liria, prona, siguria, rezistenca ndaj shtypjes).
 - kufizimi i dallimeve shoqërore vetëm mbi bazën e dobisë së përbashkët.
 - etj.
- b) Disa faktorë (ekonomikë, shoqërorë ose politikë) që çuan në shpërthimin e Revolucionit Francez janë: **2 pikë**
- Ekonomikë: kriza financiare e shtetit, borxhet, taksat e rënda mbi shtresën e tretë, etj.
 - Shoqërorë: pabarazitë midis tri shtresave, privilegjet e fisnikërisë dhe klerit, etj.
 - Politikë: dobësia e monarkisë, mungesa e përfaqësimit, ndikimi i ideve iluministe, etj.
- c) Ndikimi që pati Revolucioni Francez në zhvillimet politike në Evropë duket në: **1 pikë**
- përhapjen e ideve të lirisë, barazisë dhe të drejtave të njeriut.
 - nxitjen e revolucioneve të tjera në Evropë.
 - dobësimin e monarkive absolute.
 - zhvillimin e kushtetutave dhe shteteve moderne.
 - etj.

a) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi identifikon një nga idetë kryesore politike të shprehur në dokument.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **2 pikë**

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon dy nga faktorët (ekonomikë, shoqërorë ose politikë) që çuan në shpërthimin e Revolucionit Francez.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon një faktor (ekonomikë, shoqërorë ose politikë) që çoi në shpërthimin e Revolucionit Francez.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon një ndikim që pati Revolucioni Francez në zhvillimet politike në Evropë.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Politiko-gjyqësore: Në aparatit administrativ vendosi fëmijët, nipërit dhe bashkëpunëtorët. Kishte këshillin (divanin) si një organ konsultativ i përbërë nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë. Pranë tij ishte vendosur një përfaqësi konsullore dhe diplomatike. Ai kishte pozitën e një sundimtari absolut. Sistemin e zakonshëm gjyqësor osman si vezir ai e pasuroi me gjykata të krahinave autonome. Etj.
- Ekonomike: Ali Pasha goditi familjet e vjetra feudale dhe u mbështet te feudalët e rinj, të cilët i shpërbleu me pronat e konfiskuara. Ai i kushtoi vëmendje zhvillimit të zejtarisë dhe të tregtisë duke shpartalluar çetat dhe bandat e kusarëve. Në Janinë kishte punishte e manifaktura gëzofi, lëkurësh, argjendari, etj. Janina kishte rreth 2000 dyqane. U ndërtuan rrugë, ura, ujësjellës, vepra fortifikuese. Ai zhvilloi tregtinë me shumë shtete. Etj.
- Ushtarake: Ali Pasha e pajisi pashallëkun e vet me sistem mbrojtjeje, me një ushtri të stërvitur me parimet ushtarake evropiane. Ai krijoi armën e policisë dhe rrjetin e informacionit brenda dhe jashtë perandorisë, si dhe vuri sistemin e pasaportave. Etj.

3 pikë Nëse nxënësi përshkruan një nga elementët shtetërorë të Pashallëkut të Janinës nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës në të tri aspektet: politiko-gjyqësore, ekonomike dhe ushtarake.

2 pikë Nëse nxënësi përshkruan një nga elementët shtetërorë të Pashallëkut të Janinës nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës në dy prej tri aspekteve: politiko-gjyqësore, ekonomike dhe ushtarake.

1 pikë Nëse nxënësi përshkruan një nga elementët shtetërorë të Pashallëkut të Janinës nën drejtimin e Ali Pashë Tepelenës në një prej tri aspekteve: politiko-gjyqësore, ekonomike dhe ushtarake.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 27 **4 pikë****Model përgjigje:**

- a) Projektet për copëtimin e Shqipërisë u përfshinë në dy platforma politike: "Megali Idea"-platformë politike greke ideuar nga Joanis Koletis; "Naçertania"- platformë politike serbe ideuar nga Ilija Garashanin. **1 pikë**
- b) Sipas këtyre projekteve: **2 pikë**
- "Megali Idea" parashikonte kthimin e Greqisë në një shtet të madh me kryeqytet Stambollin, ku do të përfshiheshin tokat shqiptare deri në lumin Drin.
 - "Naçertania" parashikonte përtëritjen e shtetit të Stefan Dushanit, ku do të përfshihej Shqipëria e Veriut dhe Kosova.
- c) Edhe pse të dyja qeveritë, ajo serbe e greke, ishin dakort për ndarjen e tokave shqiptare mes tyre, për mosbesim ndaj njëra-tjetrës, marrëveshjet nuk u realizuan. Austro-Hungaria ishte kundër daljes së Serbisë në Adriatik. Italia kundërshtonte fuqizimin e Greqisë apo edhe të Serbisë përballë saj. **1 pikë**

a) 1 pikë

1 pikë Nëse nxënësi përcakton dy platformat politike për copëtimin e territoreve shqiptare.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) 2 pikë

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon se çfarë parashikonin të dy platformat politike për copëtimin e territoreve shqiptare.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon se çfarë parashikonte vetëm një platformë politike për copëtimin e territoreve shqiptare.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) 1 pikë

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon arsyen se përse nuk u realizuan këto platforma.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 **4 pikë****Model përgjigje:**

- a) Sipas dokumenteve: **2 pikë**
- Thatcher ishte për reduktimin e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.
 - Blair ishte për rol aktiv të shtetit, por brenda kuadrit të përgjithshëm të ekonomisë së tregut.
 - etj.
- b) Reformat e: **2 pikë**
- Thatcher: zvogëloi subvencionet shtetërore për kompanitë publike që dilnin me humbje; zbatoi një program për privatizimin; ulja e tatimit të fitimit, sidomos për shtresën e pasur; ndikimi i sindikatave u kufizua ndjeshëm, etj.
 - Blair: ruajti një pjesë të rëndësishme të masave të marra nga Thatcher në favor të tregut të lirë dhe sipërmarrjes private; investime në arsim/shëndetësi; ndërmori politika sociale (New Labour) për të luftuar pabarazinë, etj.

a) 2 pikë

2 pikë Nëse nxënësi identifikon ndryshimin kryesor në qasjen ndaj rolit të shtetit në ekonomi midis Margaret Thatcher dhe Tony Blair.

1 pikë Nëse nxënësi përshkruan vetëm njërin anë, por pa dalë i qartë krahasimi.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) 2 pikë

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon një nga reformat ekonomike ose shoqërore të ndërmarrë nga Margaret Thatcher dhe një nga reformat ekonomike ose shoqërore të ndërmarrë nga Tony Blair.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon një reformë ekonomike ose shoqërore të ndërmarrë vetëm nga njëri prej tyre, ose Margaret Thatcher, ose Tony Blair.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 **2 pikë****Model përgjigje:**

Në Slloveni procesi ishte më paqësor, sepse kishte homogjenitet etnik, prandaj dhe konflikti ishte i shkurtër, disaditor.

Në Kroaci ishte i dhunshëm, sepse në këtë territor jetonte një numër i konsiderueshëm serbësh, të cilët u armatosën nga regjimi serb dhe kërkonin bashkimin me Serbinë, ndërsa në Bosnje jetonin tre grupe popullsie: myslimanët, serbët dhe kroatët, ku asnjëri prej tyre nuk përbënin shumicën; pra, ndarja etnike, ndërhyrja ushtarake, interesat territoriale ishin arsye pse procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë në disa republika ishte i dhunshëm.

Etj.

2 pikë Nëse nxënësi vlerëson pse procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë ishte paqësor në disa republika dhe i dhunshëm në të tjera.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon vetëm njërin rast, pa bërë krahasim apo vlerësim.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 **3 pikë****Model përgjigje:**

a) Sipas burimit të përdorur, modeli ideologjik ose politik që mbështet autori për vendet e Evropës Lindore është:

1 pikë

- modeli socialist/komunist sovjetik.
- ose sistemi njëpartiak i udhëhequr nga Partia Komuniste.
- ose orientimi drejt Bashkimit Sovjetik dhe socializmit.
- etj.

b) Dy tipare të tjera të përbashkëta të sistemit politik, që i imponuan vendeve të Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore ishin:

2 pikë

- sistemi njëpartiak dhe ndalim i opozitës, pra totalitarizëm.
- ekonomia e centralizuar dhe planifikim shtetëror.
- kontrolli ideologjik dhe censura.
- represioni politik nga ana e policisë sekrete.
- varësia nga BRSS.
- etj.

a) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi tregon model ideologjik ose politik që mbështet autori për vendet e Evropës Lindore.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **2 pikë**

2 pikë Nëse nxënësi shpjegon dy tipare të tjera të përbashkëta të sistemit politik që i imponuan vendeve të Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore.

1 pikë Nëse nxënësi shpjegon një tipar tjetër të përbashkët të sistemit politik që i imponua vendeve të Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **3 pikë****Model përgjigje:**

- Princ Vidi, edhe pse u largua me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, nuk abdikoi nga fronti dhe vendosja e republikës do të bënte shkëputjen nga monarkia. Në këtë mënyrë nuk i jepej asnjë mundësi princit gjerman të pretendonte rikthimin në Shqipëri.
- Në Shqipëri nuk kishte asnjë traditë të një familjeje mbretërore vendase, që të mund të ruhej tradita e monarkisë. Prandaj, republika do të krijonte mundësinë të hidheshin themelet e një forme demokratike në qeverisje.
- Me republikën, Ahmet Zogu do të fitonte përkrahjen e shtresave më të gjera të popullit, të elementeve më demokratikë, të cilët do ta shikonin atë si një lider me prirje perëndimore dhe përparimtare.
- Ahmet Zogu, me republikën do të krijonte përshtypjen e një lideri demokrat dhe përparimtar edhe në sytë e botës dhe fuqive të kohës.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse nxënësi jep tri argumente të cilat çuan në shpalljen e Republikës në Shqipëri në vitin 1925.
- 2 pikë** Nëse nxënësi jep dy argumente të cilat çuan në shpalljen e Republikës në Shqipëri në vitin 1925.
- 1 pikë** Nëse nxënësi jep një argument i cili çoi në shpalljen e Republikës në Shqipëri në vitin 1925.
- 0 pikë** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **2 pikë**

Model përgjigje:

- Ndërrimi i shpeshtë i qeverive dhe destabiliteti që krijohej.
- Lëvizjet antiqeveritare, si ajo e Gjon Marka Gjonit, Elez Isufit.
- Atentati ndaj Ahmet Zogut në shkurt 1924, që shkaktoi plagosjen dhe dorëheqjen e tij si kryeministër.
- Atentati ndaj Avni Rustemit, në 20 prill 1924, që shkaktoi vdekjen e tij.
- Vrasja e dy turistëve amerikanë në Mamurras.
- Revolucioni i Qershorit 1924, i cili, nga disa historianë, konsiderohet kryengritje e nga disa të tjerë grusht shteti.
- Rikthimi i Ahmet Zogu, i cili, i ndihmuar nga jugosllavët, sulmoi nga veriu dhe jugu vendin e, në 24 dhjetor 1924, hyri në Tiranë, mori me forcë pushtetin, ndërsa Fan Noli u largua bashkë me qeverinë dhe bashkëpunëtorët e tij.
- Etj.

2 pikë Nëse nxënësi përshkruan dy nga momentet e jetës politike shqiptare në këto vite, që tregojnë kaosin dhe destabilitetin politik.

1 pikë Nëse nxënësi përshkruan një moment të jetës politike shqiptare në këto vite, që tregon kaosin dhe destabilitetin politik.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **3 pikë**

Model përgjigje:

- a) Shkaqet që çuan në rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri ishin: **1 pikë**
- kriza ekonomike.
 - izolimi ndërkombëtar.
 - ndikimi i ndryshimeve në Evropën Lindore.
 - etj.
- b) Ngjarja kyçe që çoi në rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri ishte lëvizja Studentore e Dhjetorit 1990. **1 pikë**
- c) Pasoja kryesore që solli rënia e regjimit komunist në Shqipëri ishte vendosja e pluralizmit politik. **1 pikë**

a) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton një nga shkaqet që çoi në rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton ngjarjen kyçe që çoi në rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.

c) **1 pikë**

1 pikë Nëse nxënësi përcakton pasojën kryesore që solli rënia e regjimit komunist në Shqipëri.

0 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar **OSE** nuk përgjigjet fare.